**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË**

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

TDR GROUP
SHOQËRI PËRMBARIMI

QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT
Nr. 4978 Prot.
Datë 2.8.2016

Nr. 2088 Prot
Nr. 1062/1 Dosje

Tiranë,më 27.07.2015

# V E N D I M

## PER PUSHIMIN E EKZEKUTIMIT

Unë, Rigels Bejko, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat, pranë Shoqërisë së Përmbarimit **"TDR Group"** sh.p.k.**,** në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Nr. 7756/U vendimi, të lëshuar me Datë 15.10.2015 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kam vënë në ekzekutim këtë *Urdhër*, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr. 1062/1, Datë 21.12.2015 kërkesën e kreditorit Z Sokol Balla, perfaqesuar me prokure te posacme nga Av. Sonila Elezi ndaj debitorit shoqeria "Lapsi.al" shpk, në lidhje me titullin "Vendim Nr. 7756, të lëshuar me Datë 15.10.2015 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë".

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorit Lajmërimin Nr. 2984 Prot, Datë 21.12.2015, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhri i Ekzekutimit Nr.7756/U vendimi, Datë 15.10.2015, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

Urdherat per vendosjen e sekuestrove konservative jane derguar ne :

a) 16 – Bankat Tregetare, me shkresen Nr. 7 Prot. Dt 05.01.2016.
b) Qendren Kombetare te Regjistrimit (QKR-Tirane), me shkresen Nr. 9 Prot. Dt. 05.01.2016.
c) Drejtorine Rajonale te Sherbimit te Transportit Rrugor Tirane (DRSHTR), me shkresen Nr. 8 Prot. Dt. 05.01.2016.

Lidhur me sa me siper, duke zhvilluar dhe kryer veprimet proceduriale te nevojshme per ekzekutimin e plote te titullit ekzekutiv me palet e lartpermendura,

## KONSTATOJ

Se debitori shoqeria "Lapsi.al" shpk, me NIPT L51327021A, ka permbushur plotësisht detyrimin, ndaj kreditorit Z Sokol Balla.

Në këto kushte, referuar nenit 616 Pika (a) të Kodit te Procedurës Civile dhe nenit 32. Pikat (b,c) te Ligjit Nr. 10031, date 11.12.2008 "Për Shërbimin Permbarimor Gjyqësor Privat",

**VENDOSA**

1. Pushimin e ekzekutimit të Urdhërit të Ekzekutimit, Vendim Nr.7756/U vendimi, të lëshuar me Datë 15.10.2015 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

2. Urdhërohen Bankat Tregetare të Nivelit II, të zhbllokojnë nga masa e sekuestros konservative depozitat, kredite apo llogarite bankare te **Shoqerise "Lapsi.al" sh.p.k.**, me Nr. NIPT **L51327021A**, te bllokuara me shkresen Nr. 7 Prot. Dt 05.01.2016, te Shoqerise Permbarimore Private "TDR Group".

3. Urdhërohet QKR Tirane ,të zhbllokojë nga masa e sekuestros konservative menjehere aksionet e **Shoqerise "Lapsi.al" sh.p.k.**, me Nr. NIPT **L51327021A**, te bllokuara me shkresen Nr. 9 Prot. Dt 05.01.2016, te Shoqerise Permbarimore Private "TDR Group".

4. Urdhërohet Drejtorine Rajonale Te Sherbimit Te Transportit Rrugor **Tirane** (DRSHTR) të zhbllokojë nga masa e sekuestros konservative menjehere aksionet e **Shoqerise "Lapsi.al" sh.p.k.**, me Nr. NIPT **L51327021A**, te bllokuara me shkresen Nr. 8 Prot. Dt 05.01.2016, te Shoqerise Permbarimore Private "TDR Group".

5. Ky vendim t'u njoftohet menjëherë palëve.

6. Një kopje e vendimit të pushimit t'i dorëzohet kreditorit, së bashku me urdhërin e ekzekutimit, i cili me të marrë dijeni të kryejë veprimet përkatëse pranë llogarisë bankare të shoqërisë "TDR Group".

7. Ky vendim mund te ankimohet përpara Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, brenda 5-ditësh.

**SHOQËRIA E PËRMBARIMIT PRIVAT "TDR GROUP" sh.p.k.**

**PËRMBARUES GJYQËSOR**

**RIGELS BEJKO**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - "TDR-GROUP" sh.p.k. - SHOQËRIA PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT

TDR GROUP
Shoqëria Përmbarimore Gjyqësore Private "TDR Group" Sh.p.k
Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Kulla Nr. 5, Kati i 11-të, Nr. 54, Tiranë
Tel: 00355 42 427790
www.tdr.al